

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 09.02.2019

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	10	
4. Problemi 4	5	
5. Problemi 5	5	
6. Problemi 6	5	
Total	100	

1. Kompania BLU jep mallra për disa nga klientët e vet me marrëveshje konsignacioni. Si duhet të trajtohen mallrat e dhënë me këtë opcion?
 - a) Rregjistrohen si blerje malli tek klientët e BLU-së;
 - b) Nuk regjistrohen nga ana e klientëve;
 - c) Rregjistrohen si shitje nga ana e BLU-së;
 - d) Asnjëra më lartë;

2. Një tatimpagues (i paregjistruar për Tvsh) gjatë periudhës 01 korrik 2017 – 30 qershor 2018 ka bërë qarkullim (shitje) në vlerë prej 31,000 Euro. Shitjet kanë qenë të njëtrajtëshëm në baza mujore gjatë kësaj periudhe. Tatimpaguesi a konsiderohet person i tatueshëm për Tvsh në vitin 2018, (përveq nëse regjistrohet vullnetarisht) në këtë rast:
 - a) Po, pasi ka kaluar pragun prej 30,000 Euro gjatë periudhës së lartëpërmendur;
 - b) Jo, sepse pragu i regjistrimit si person i tatueshëm është mbi 50,000 Euro;
 - c) Jo, pasi nuk është kaluar pragu prej 30,000 Euro e më lartë për tu regjistruar në Tvsh gjatë një viti kalendarik;
 - d) Asnjëra më lartë.

3. Për qëllime tatimore për njohjen e KMSH në fund të vitit cila metodë lejohet për trajtimin e stokeve?
 - a) Lejohet metoda FIFO dhe LIFO;
 - b) Lejohet metoda LIFO dhe Kosto Mesatare;
 - c) Lejohet metoda Kosto Mesatare dhe FIFO;
 - d) Asnjëra më lartë.

4. Klerti Krasniqi në muajin Qershor 2018 ka pasur rrogën Bruto prej 850.00 Euro. Në Korrik të vitit 2018, menaxhmenti vendosi që paga e Klertit të rritet për Neto vlerë prej 50.00 Euro. Sa do të jetë paga Bruto në Qershor të vitit 2018 për Klertin?
 - a) 900.00 Euro;
 - b) 897.50 Euro;
 - c) 905.00 Euro;
 - d) 908.48 Euro.

5. Kompania "ART", në Tetor pranon një notë kreditore nga kompania "TRA" për blerjet të cilat i ka bërë para dy muajve nga kjo e fundit. Nota kreditore e pranuar nga "TRA" është në vlerë 2,900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "ART" kjo notë ka ndikim në deklaratë të Tvsh-së që:
- rrit Tvsh e zbritshme;
 - rrit Tvsh e llogaritur;
 - zvogëlon Tvsh e zbritshme;
 - zvogëlon Tvsh e llogaritur.
6. Kompania "RIANI" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 1,000.00 (pa e përfshirë Tvsh) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 8% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e faturës pas zbritjes duke përfshirë edhe Tvsh me normë prej 18% për furnizimin e bërë?
- 1,100.00 Euro;
 - 1,180.00 Euro;
 - 1,085.60 Euro;
 - 1.080.00 Euro.
7. Fature në vlerë prej 880.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkuluar gabimisht me Tvsh prej 8% duhet te korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë klienti ka kërkuar që të kthehet edhe një pjesë e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar në faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 220.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera totale e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
- 660.00 Euro;
 - 620.40 Euro;
 - 792.00 Euro;
 - 701.88 Euro.
8. Biznesi FLANDRA shpk ka lëshuar një objekt me qera në vlerë 500 Euro Bruto një biznesi për qëllime afariste, veprimtaria afariste e të cilit është shërbime të dizajnit dhe arkitekturës, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me Tvsh. Sa është norma e tatimit në qera të cilën duhet ta paguajë FLANDRA shpk?
- 0%;
 - 3%;
 - 9%;
 - 10%;

9. Kompania "BAT" është biznes i cili tatóhet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 3 ortakë (Blendi, Arbeni dhe Toni) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria dhe ortakët me 31.12.2017 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:

- a) secili ortakë DO;
- b) secili ortakë deklaratën e PD-së.**
- c) ortakët së bashku një deklaratë të PD-së;
- d) Asnjëra më lartë.

10. Qytetari, Shaban Gashi i lindur më datë 09 shkurt 1950 në Mramor të komunës së Prishtinës ka pagën bruto prej 400 Euro. Sa është paga NETO e Shaban Gashit për muajin Janar 2019?

- a) 400.00 Euro;
- b) 381.20 Euro;**
- c) 380.00 Euro;
- d) 362.80 Euro;

1. Gjatë ose pas regjistrimit në ARBK, një Shoqëri Tregtare, duke përfshirë Bizneset Individuale mund të dorëzojnë aplikacion në ARBK për shfrytëzimin e një Emri Tregtar që është i ndryshëm nga Emri Zyrtar i Shoqërisë Tregtare.

E saktë

E pasaktë

2. Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë Aksionare duhet të jetë më së paku në shumën prej 5.000 Euro ose në ndonjë shumë tjetër më të madhe nëse kjo kërkohet në bazë të nenit 145 të këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", për qëllime të këtij Ligji, klasifikohen si mikro-ndërmarrje, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual, sipas kritereve të mëposhtme:

1. pasqyra e pozitës financiare;
2. qarkullimi neto; dhe
3. vlera e llogarive të arkëtueshme.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", raporti i auditimit nënshkruhet nga auditori ligjor, ku firmoset edhe data e nënshkrimit; kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nuk nënshkruhet nga auditori ligjor që kryen auditimin në emër të firmës së auditimit;

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo tatimpagues pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrimeve të parapara me ligj, kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimet e parapara sipas këtij paragrafi duhet të jenë të gatshme më apo para 10 janarit të vitit vijues.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të gjithë personat e angazhuar në tregti ose afarizëm të cilët taten në bazë të të hyrave reale dhe që bëjnë blerje të mallrave ose shërbimeve nga personi tjetër i tatueshëm në gjithsejtë njëmijë (1,000) Euro e më shumë në çdo vit të tatueshëm, duhet të paraqesin deklaratë të vërtetë dhe të saktë duke raportuar blerjet e tilla tek ATK-ja. Deklaratat vjetore obliguese me këtë nen do të dorëzohen në ATK.

E saktë

E pasaktë

7. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo person (përfshirë këshilltarët tatimor/kontabilistin) i cili nënshkruan një deklaratë tatimore në emër të një personi tjetër, i cili bën një gabim në atë deklaratë, do të paguajë një ndëshkim administrativ prej njëqindnjëzetepesë (125) Euro. Ndëshkimi do të vendoset vetëm nëse gabimi është rezultat i neglizhencës apo paramendimit nga ana e personit që nënshkruan deklaratën tatimore.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet për ndjekje të programit të trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marrë pjesë në programet zyrtare të trajnimit për të marrë shkathtësitë që lidhen me punën, lejohen plotësisht në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, që pranon qira, ndan nëntë për qind (9%) të tatimit në të ardhurat bruto, në kohën e arkëtimit dhe do ta transferojë tatimin e mbajtur në burim, në një llogari të caktuar nga ATK-ja në bankën ose institucionin financiar të licencuar nga BQK-ja. Tatimi i mbajtur në burim paguhet deri në ditën e 15 të muajit pasues.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në pesë për qind (5%) të të ardhurave bruto vjetore.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, personi apo entiteti jo-rezidentpavarësisht nga dispozitat tjera në këtë ligj, shuma e mbajtjes në burim do të jetë dhjetë për qind (10%) e kompensimit bruto. Secili pages do të dorëzojë një pasqyrë të mbajtjes në burim dhe të transferojë shumën e tatimit të mbajtur në burim në një llogari të caktuar nga ATK-ja në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit nuk do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit të Tvsh-së, kur pagesa duhet të bëhet apo është bërë në llogari para se mallrat dhe shërbimet të jenë furnizuar, Tvsh-ja duhet të bëhet e ngarkueshme në pranimin e pagesës dhe në shumën e pranuar.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit të Tvsh-së, për shërbimet spitalore, kujdesi mjekësor dhe aktivitetet e lidhura ngushtë të ndërmarra nga organet e rregulluara me ligjet në fuqi të Kosovës, nga spitalet, qendrat për trajtime mjekësore ose diagnostifikim dhe institucionet tjera të njohura me natyrë të ngjashme llogaritet dhe paguhet norma e reduktuar e Tvsh-së prej tetë përqind (8%).

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit të Tvsh-së, një person i tatueshëm duhet të dorëzojë një deklaratë tatimore jo më vonë se deri më datën 15 të muajit vijues dhe të bëjë pagesën përkatëse më së voni deri në datën 20 të muajit kalendarik që pason pas fundit të secilës periudhë tatimore.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit të Punës, femra e punësuar gëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë dhe gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit të Punës, punëdhënësi nuk është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit mbi Pensionet ne Kosove, shuma maksimale e lejueshme vullnetare është 10% të pagës bruto për pjesën e punëdhënësit dhe 10% të pagës bruto për pjesën e të punësuarit.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore**Problemi 1****20 pikë**

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues i kompanisë VALDRINI Sh.p.k i datës 31. 12.2018:

Përshkrimi i llogarive	Debi	Kredi
Banka	137,500	
Arka	330	
Llogarite e arkëtueshme	325,353	
Parapagimet	122,623	
Stoku	230,000	
Kamioni dhe Veturat	180,000	
Zhvlerësimi i akumuluar (Kamion dhe Vetura)		32,400
Pajisje	24,500	
Zhvlerësimi i akumuluar (Pajisje)		6,125
Makineri e rëndë	550,000	
Zhvlerësimi i akumuluar		66,000
Llogaritë e pagueshme		109,161
Tatimi në burim		1,080
Akrualet e pagueshme		30,350
Kapitali themelor		330,000
Obligimet për pension (CM)		1,338
Obligimet për TAP		920
Obligimet për paga Neto		11,791
Tvsh e zbritshme	3,200	
Kredia bankare		87,627
Shitjet/Te hyrat		2,953,421
KMSH	1,120,901	
Shpenzimet e komunikimit	28,051	
Shpenzimet e rrymes	83,080	
Shpenzimet e kontributeve pensionale	8,028	
Shpenzimet mjekësore	532	
Shpenzimet bankare	3,916	
Shpenzimet e zhvlerësimit	104,525	
Shpenzimet e provizioneve të LL/ Arkëtueshme	9,761	
Shpenzimet e sigurimit	496	
Shpenzimet e interesit	15,515	
Shpenzimet e donacionit	150,000	
Shpenzimet e derivateve	116,023	
Shpenzimet e zyres	21,264	
Shpenzimet e pagave Bruto	160,556	
Shpenzimet profesionale	17,060	
Shpenzimet e qerasë	144,000	
Shpenzimet e marketingut	25,000	
Shpenzimet e përfaqësimit	48,000	
TOTAL	3,630,213	3,630,213

Informacion shitesë:

- 1) Kompania ka filluar aktivitet në këtë vit;
- 2) Makineria e rëndë i takon grupit të tretë të aseteve, është importuar nga Gjermania;
- 3) Shpenzimet e Interesit vetëm janë përlllogaritur, pagesa do të fillon pas dy viteve sipas Marrëveshjes me bankën;
- 4) Shpenzimet e provizioneve për llogaritë e arkëtueshme janë vendim i menaxhmentit;
- 5) Qiraja dhe pagat e muajit 12 do të paguhet në Maj të vitit 2019. Nuk ka pas ndryshim të qirasë dhe pagave nga Janari deri në Dhjetor, pra shpenzimet mujore të njëtrajtshme;
- 6) Te rishikohet çdo shpenzim i limituar sipas Ligjit "Për tatimi në të ardhurat e korporatave".

Kërkohet:

- a) Llogaritni fitimin para tatimit kontabël të kompanisë?
- b) Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave?

Zgjidhje:

Shitjet/Të hyrat	2,953,421
KMSH	(1,120,901)
Fitimi Bruto	1,832,520
Shpenzimet totale (sipas kontabilitetit)	(935,806)
Fitimi para tatimit (kontabel)	896,714
Rregullimet:	
Zbritja e veçantë (2*)	(55,000)
Shpenzimet e interesit (3*)	+15,515
Shpenzimet e provizionit të LL/ A (4*)	+9,761
Shpenzimet e qerasë dhe Pagave (5*)	+26,049
Shpenzimet e përfaqësimit (6*)	+18,466
Shpenzimet e zhvlerësimit (7*)	+8,625
Donacioni	+150,000
Fitimi para donacionit	1,070,130
Shpenzimet e donacionit (8*)	(107,013)
Fitimi para tatimit	963,117
Tatimi @10%	(96,312)
Fitimi neto	866,805

Sqarime:

2* Zbritja e veçantë për makinerinë e rëndë sipas ligjit TAK për vitin e parë, neni 17 pika 1 prej 10%. $550,000 \times 10\% = 55,000$ shpenzim;

3* Interesi i pa paguar nuk njihet si shpenzim në atë periudhë;

4* Shpenzimet e provizionit në LL/A nuk pranohet shpenzim i vitit sipas TAK;

5* Qiraja dhe pagat e muajit Dhjetorit nuk pranohen shpenzim për këtë periudhë pasi që nuk do të paguhet deri më 31 Mars të vitit në vijim.

Qiraja	- 144,000/12=	12,000
Paga	- 160,556/12=	13,380
Pensioni	8,028/12 =	669
Total		26,049

6* Shpenzimet e përfaqësimit të kufizuara në vetëm 1% të shitjeve dhe atë:

$2,953,421 \times 1\% = 29,534$ shpenzime të lejuara ;

Shpenzime të ndodhura 48,000 - 29,534 = 18,466 (shpenzime të pazbritshme);

7* Zhvlerësimi:

Grupi II:

Kamiona dhe vetura $180,000 \times 20\% = 36,000 - 32,400$ (kontabilitet) = 3,600- rritje zhvlerësimit

Paisje $24,500 \times 20\% = 4,900 - 6,125$ (kontabilitet) = 1,225 - zvogëlim zhvlerësimit

Grupi III:

Makineria e rëndë $550,000 \times 10\% = 55,000 - 66,000$ (kontabilitet) = (11,000) - zvogëlim zhvlerësimit

TOTAL shpenzim i pazbritshëm **8,625**

8* Donacioni i lejuar vetëm 10% e fitimit para donacioni.

Problemi 2**15 pikë**

Gjatë muajit Korrik 2018, "DIONI" shpk regjistrojë blerje në shumën prej 20,000 Euro (TVSH me normën 18%); shitje vendore 15,000 Euro (me normë 18% të TVSH-së); shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi 33,000 Euro. Në muajin Korrik 2018, poashtu DIONI shpk ka lëshuar një Note Debiti për një blerës për një shitje në muajin Mars 2018, vlera e TVSH-së në këtë Note Debiti është 1,000 Euro (me normë standarde); DIONI shpk poashtu në këtë muaj kishte një kreditim të bartur nga muaji paraprak në vlerë prej 3,300 Euro.

(Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë TVSH-në).

Sa për informacion "DIONI" shpk gjatë vitit 2017 regjistrojë blerje në shumën prej 420,000 Euro. Shitjet vendore ishin 880,000 Euro dhe eksportet ishin 50,000 Euro. Shitjet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi për vitin 2017 ishin 400,000 Euro.
(Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë TVSH-në).

Kërkohet:

- a) Sa është koeficienti i TVSH-së së zbritshëm për vitin 2017? 5 pikë
 b) Sa ka detyrim/kreditim të TVSH-së në muajin Korrik 2018 për "DIONI" shpk? 10 pikë

Zgjidhje:

a)

$$KT = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet} + \text{Furnizimet e përjashtuara}} \times 100 =$$

$$= \frac{880,000 + 50,000}{880,000 + 50,000 + 400,000} \times 100 = \sim 70\%$$

b)

LIBRI I SHITJEVE:

Shitjet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi	33,000.00
Shitjet vendore	15,000.00 x 18% = 2,700.00
Nota debitore e lëshuar me normë 18%	<u>5,555.55 x 18% = 1,000.00</u>
TOTAL TVSH e llogaritur	3,700.00

LIBRI I BLERJEVE:

Blerjet pa të drejtë kreditimi (I1)	7,080.00
Blerjet (20,000 x 70%) (I2)	<u>14,000.00 x 18% = 2,520.00</u>
TOTAL TVSH e zbritshëm	2,520.00

$$\text{Kalkulimi i TVSH-së} = \text{TVSH e llogaritur} - \text{TVSH e zbritshëm} - \text{Kreditimi i bartur}$$

$$= 3,700 - 2,520 - 3,300 \Rightarrow \text{kreditim në vlerë 2,120 Euro}$$

(I1) $20,000 \times 30\% = 6,000 \times 18\% = 1,080$ vlerë e Tvsh-së që nuk pranohet e zbritshëm dhe pjesa tjetër- $6,000$ (baza e kostos pa të drejtë kreditimi) $+ 1,080 = 7,080$

(I2) $20,000 \times 70\% = 14,000 \times 18\% = 2,520$ TVSH e zbritshëm pasi që sipas ligjit të Tvsh duhet përdoret koeficienti i vitit paraprak.

Problemi 3

10 pikë

JONI sh.p.k. ka deklaruar dhe paguar me dy muaj vonesë sipas kohës së paraparë me ligj për periudhën tatimore 05/2017 për TVSH shumën prej 25,000 Euro. Në muajin Maj 2018 ka pranuar aktin final të kontrollit për periudhën 05/2017 për TVSH. Në aktin final ATK ka konstatuar tatim shtesë prej 10,000 Euro.

Kërkohet:

Sa janë gjordat dhe interesi për tatimin shtesë (sipas aktvendimit të ATK-së) që kompania duhet paguar duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore?

Zgjidhje:

1* Gjorda për nën deklarim tatimor	$10,000 \times 25\%$	= 2,500
2* Gjorda për mos deklarim në kohë	$10,000 \times 10\%$	= 1,000
3* Gjorda për mos pagesë në kohë	$10,000 \times 10\%$	= 1,000
4* Interesi	$10,000 \times 7.8\%$	= 780
TOTALI		5,280

1* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat ATK-se, nëse nën deklarimi është me i larte se 10% ndëshkimi është 25% i shumës së nën deklaruar.

2* Neni 51 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-se, për mos deklarim të tatimit në kohë ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 2 muaj vonesë.

3* Neni 51 pika 2 i ligjit për procedurat ATK-se, për mos pagesë tatimit në kohë ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 10 muaj.

4 * Neni 28 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-se, deri në ditë e pagesë se tatimit llogaritet interes 0.65% në muaj. Në rastin konkret ne kemi të bëjmë me 12 muaj mos pagesë të tatimit.

Problemi 4

5 pikë

Kompania ABC LLC për vitin 2018 ka pasur një fitim neto 1,350,000 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 150,000 Euro. Parapagimi i kësteve të barabarta ka qenë në shumë prej 35,000 EUR (metoda historike), diferenca prej 10,000 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2018.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2019 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave nuk do të vazhdojë të paguhet bazuar në metodën e “**strehës së sigurt**”, pasi është planifikuar sipas buxhetimit se fitimi para tatimit (FPT) do të jetë rreth 1,200,000 Euro për vitin 2019 dhe i cili do të jetë i njëtrajtshëm gjatë gjithë vitit 2019.

Kërkohet:

Sa do të jetë shuma e një kësti për vitin 2019 për Kompaninë “ABC LLC” nëse aplikohet metoda e parashikimit.

Zgjidhje:

Për periudhën vijuese të vitit 2019, paguhet një e katërta (1/4) e detyrimit tatimor të parashikueshëm (në këtë rast të vitit 2019), që ishte 120,000 Euro (FPT 1,200,000×10%).

Kalkulimi për këstet e vitit 2019:

$$120,000 \times \frac{1}{4} = 30,000 \text{ Euro.}$$

Problemi 5**5 pikë**

Kompania ABC shpk ka të punësuar një Menaxher, paga e të cilit për muajin Janar 2018 është si me poshtë:

Paga Neto
Menaxheri 1,300

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga dhe KP për muajin Janar 2018 të këtij puntori. (Kujdes paga është **neto**).

Zgjidhje:

1. Menaxheri: paga Janar = 1,300

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla Tatimi e tat.	Paga	Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0.00	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.80	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00	427.20
4. (3*)	969.78	10%	96.98	872.80 (3*)	1,300.00
TOTAL	1,419.78		119.78	1,300.00	

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3*) diferenca e pages neto 80+163.20 +184= 427.20

Paga neto e menaxherit: 1300 - 427.20= 872.80/90%= 969.78

KP:

Baga bruto 1,419.78/95%= 1,494.51

KP = 1,419.78x 5% = 74.73 +74.73 = 149.46

Problemi 6**5 pikë**

Kompania LURA gjatë muajit Janar 2019 ka pasur dy objekte/lokale të marra me qera me kontratë mujore: Lokali 1: Qeraja bruto 500.00 Euro dhe Lokali 2 Qeraja Neto 500,00 Euro. Vlerat përkatëse të qerasë janë paguar gjatë muajit Janar 2019.

Kërkohe:

Të kalkuloheh tatimi i mbajtur në burim (pjesa e qerasë) për muajin Janar 2019?

Zgjidhje:

Lokali 1: 500 Euro bruto (bazë për kalkulim)

Lokali 2: 500 Euro neto => 549.45 bruto (bazë për kalkulim)

Total bruto Lokali 1+ Lokali 2= 500.00+549.45= 1,049.45

Tatimi i mbajtur në burim : 1,049.45 x 9% = 94.45

Ekstrakt i deklaratës së tatimit të mbajtur në burim (qera):

a. Tatimi i mbajtur në burim në interes, të drejta pronësore, fitimet ne lotari dhe lojra të fatit.		
[8] Interesi bruto i paguar për muajin.....	[8]	0.00
[9] Të drejtat pronësore të paguara për muajin.....	[9]	0.00
[10] Fitoret bruto në lotari dhe lojra të fatit të paguara për muajin (vetëm individëve).....	[10]	0.00
[11] Shuma totale e paguar për muajin [11]=[8]+[9]+[10].....	[11]	0.00
[12] Tatimi i mbajtur në burim përveç qirasë dhe personit jo-rezident [12]=[11] x 10%	[12]	0.00
b. Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë dhe personin jo-rezident		
[13] Qiraja bruto e paguar për muajin.....	[13]	1049.45
[14] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë e paguara [14]=[13] x 9%	[14]	94.45
[15] Pagesa bruto për personin jo-rezident (zbavitës).....	[15]	0.00
[16] Pagesa bruto për personin jo-rezident për shërbime.....	[16]	0.00
[17] Tatimi i mbajtur në burim për personat jo-rezident [17]=[15+16]x5% apo sipas METD	[17]	0.00
[18] Tatimi total i mbajtur në burim [18]=[12]+[14]+[17].....	[18]	94.45
c. Tatimi i mbajtur në burim për kategori të veçanta		
[19] Pagesat bruto për personat fizik jo-afarist për muajin	[19]	0.00
[20] Tatimi i mbajtur në burim për personat fizik jo-afarist [20]=[19] x 3%	[20]	0.00
[21] Tatimi total i mbajtur në burim [21]=[18]+[20].....	[21]	94.45

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nenshkrimi dhe Vula

(_____)

Data: 09 shkurt 2019